

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti Për Krime të Rënda, në trupin gjykues të përbërë gjyqtari Agim Ademi kryetar i trupit dhe gjyqtarëve Naser Maliqi dhe Luljete Shabani anëtar, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit L.M., nga ..., rr. " ... " nr. ..., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat S.R., nga ..., për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2. lidhur me par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PP.I. nr. 152/2017 e datës 31.07.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 09.10.2017, bie dhe në prezence të palëve me datë 10.10.2017 publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

L.M., nga i ati S. dhe nëna Z., e lindur M., i lindur me datë ..., në Rr. ..., nr. ..., ku edhe jeton, ka të kryer shkollën fillore, i pa martuar i pa punësuar, i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me datë 30.04.2017, rreth orës 15,00 h, në rrugën " ... " në ..., i shkakton lëndim të lehtë trupor të dëmtuarit A.Sh. nga ..., në atë mënyrë që për shkak të një mosmarrëveshje paraprake me të dëmtuarin, fillimisht e sulmon me një shkop druri e më pastaj e godet me gërshërë një herë në kokë dhe tre herë në shpinë duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore – plagë prerës rreth 4.cm, e që më pastaj i dëmtuari si rast urgjent është dërguar në Spitalin Rajonal në Gjilan, për trajtim mjekësor ndërkaq i akuzuari i është qasë arratisë dhe se më datë 15.07.2017 është arrestuar nga ana e Pjesëtarëve të Policisë së Kosovës në Gjilan.

Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2. lidhur me par. 1 nën par. 1.4 të KPRK-ës.

Andaj, Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21, 41, 45, 69,73,83, 114 të KPRK-ës, dhe neneve 365, 453, të KPPRK-ës.

E G J Y K O N

***Të akuzuarin L.M.**, me dënim burgu në kohëzgjatje prej 1.(një) viti e 6.(gjashtë) muaj, të cili dënim burgu i akuzuari do ta mbaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.*

Në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 15.07.2017.

Të akuzuarit i është shqiptuar edhe dënimi plotësues konfiskimi i mjetit të kryerjes së veprës penale - gërshërëve.

Obligohet i akuzuari që të paguajë paushallin gjyqësor në shumë prej 40 (dyzet) euro, si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krimeve të Rënda ka ngritur aktakuzë PP.I. nr. 152/2017 e datës 31.07.2017, kundër të akuzuarit L.M., nga ... për shkak të veprës penale vrasje në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtorë dhe të dënohet me dënim meritore sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda Arben Kadriu, fillimisht mbeti në tërësi pranë aktakuzës ndërsa në fjalën përfundimtare deklaroi se gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se i akuzuari L.M. e ka kryer veprën penale vrasje në tentativë, nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës. Gjendja faktike si në dispozitiv të aktit akuzues vërtetohet me deklaratën e të dëmtuarit A.Sh. i cili përshkruar se ditën kritike ishte vënë në lajthim nga i akuzuari kinse ishte ftuar nga H.R., duke u përgatitur për ta kryer veprën, fillimisht pasi e takon të dëmtuarin dhe e pyet a je ti A.Sh., i akuzuari fillimisht e godet të dëmtuarin me dru por që i dëmtuari arrin të mbrohet e më pas me mjet të mprehtë e godet në shpinë në pjesën e sipërme dhe në kokë dhe më pas largohet. Se i akuzuari kishte biseduar me të dëmtuarin në emër të saj dhe e kishte ftuar që të takoheshin e deklaroi edhe vet dëshmitarja H.R. . Veprimet si në dispozitiv të aktakuzës i pranon edhe vet i akuzuari duke mohuar se kishte dashje për ta privuar nga jeta të dëmtuarin. Dashja është vërtetuar me intensitetin e sulmit duke e goditur tri herë në shpinë në pjesën e sipërme dhe një herë në kokë me mjet të

përshtatshëm dhe siç deklaroi vet sulmin e ka ndërprerë kur e ka parë gjakun nga se ishte i humbur. Edhe dëshmitari K.B. e përshkruan se ka dëgjuar të shara dhe e ka parë të dëmtuarin të gjakosur në shpinë dhe kokë. Kjo gjendje faktike vërtetohet edhe me provat materiale si raporti mjekësor dhe mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko ligjor si dhe foto dokumentacioni. Andaj, i propozoj Gjykatës që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj me dënim merititor sipas Kodit Penal. Si rrethana rënduese të marr mënyrën e kryerjes së veprës penale, se pas kryerjes së veprës penale ka qenë në arrati dhe se i dëmtuari i është bashkangjitur ndjekjes penale, deri sa si rrethana lehtësuese të merret sjellja e të akuzuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor.

I dëmtuari A.Sh., deklaroi se i bashkohem ndjekjes penale ndaj të akuzuarit por nuk ushtroi kërkesë pasurore –juridike, derisa në cilësinë e dëshmitarit deklaroi se ditën kritike tani dëshmitarja H. më ka shkruar përmes facebook-ut. duke më thënë se a po vjen me më marr. Unë jam nisur në drejtim të vendit ku duhet të takoheshim me H. dhe gjatë gjithë kohës deri sa unë isha duke shkuar në këmbë kam komunikuar me të njëjtën, dhe e njëjta gjithnjë ka insistuar që të shkoi sa më shpejt. Me të arritur afër Radiostacionit “ ... ” e kam takuar tani të akuzuarin L. e të cilin më parë nuk e kam njohur dhe me atë rast i njëjti më ka pyetur se a jeni ju A. . Unë jam përgjigjur se po unë jam dhe kam vazhduar që të jem i orientuar në telefon dhe pasi që kam vazhduar 2-3 hapa i njëjti ka dashur të më godas me një shkop të gjatësisë prej 1,5 m, dhe të trashësisë 6-7 cm, por që nuk ka arritur të më godas ngase unë ia kam kapur drurin si dhe dorën dhe kam filluar të bërtas me ç ‘rast edhe druri ka rënë në tokë. Ka tentuar të më godas me grushte, por që unë jam tërhequr dhe nuk ka mundur të më godas, por as unë nuk e kam goditur. Më pas nga xhepi ka nxjerrë një thikë të bardhë dhe më ka goditur tri herë në pjesën e majtë të shpinës e më pas kur ka vërejtur se po më rrjedh gjaku i njëjti ishte i humbur dhe më ka goditur edhe një herë në pjesën e kokës mbi veshin e majtë. Më pas unë kam bërtitur dhe një djalë me flokë të bardha si dhe një person tjetër ka tentuar me na nda dhe ai personi me flokë të bardha e ka kapur L. dhe e ka larguar.

Dëshmitari K.B. deklaroi se unë kam lokalim tim të automekanikut në lagjen “ ... ” afër radiostacionit “ ... ” dhe ditën kritike ngjarja ka ndodhur rreth 50 metra larg nga lokali im. Në ato momente unë kam qenë në lokal dhe e kam dëgjuar duke u sharë dhe deri sa kam dalë nga lokali kam parë të dëmtuarin A. i cili kishte gjak në pjesën e kokës mbi veshin e majtë dhe në trup, dhe i kam thënë ndalu deri sa i njëjti ishte duke shkuar në drejtim të shkollës “ ... ” ndërsa L. ka shkuar në drejtim të rrugës “ ... ” ashtu të njëjtit i kam parë në dorë gërshërë në formë të lakuar. Në vendin e ngjarjes unë kam vërejtur se ka pasur gjak, por ndonjë mjet tjetër nuk kam parë. Pas ngjarjes L. më ka treguar se përmes Fcb. është paraqitur në emër të H. dhe fillimisht e ka goditur me shkop druri të dëmtuarin e më pastaj edhe me gërshërë.

Dëshmitarja H.R., deklaroi: se në kohën kur ka ndodhur ngjarja unë kam pasur fcb, timin dhe në fcb ka pasur qasje L. si dhe edhe unë kam pasur qasje në fcb të L. . Të dëmtuarin A.Sh. e kam njohur si figurë edhe më parë dhe i njëjti më ka shkruar përmes fcb. por edhe unë ia kam kthyer 2-3 herë duke i thënë që të mos më shkruaj ma. L. i ka pa të gjitha komunikimet të cilat i kam pasur me A. dhe pasi që L. i ka pa këto komunikime kanë filluar të shkruajnë në mes veti dhe ka filluar edhe të shahen. Unë lidhur me rastin konkret nuk kam ditur asgjë por më pas kam dëgjuar se L. ka komunikuar me A. dhe më pas ka ndodhur rrahja, dhe për këtë më ka

njoftuar L. e i cili më ka thënë se ka komunikuar në emrin tim duke e lënë të takoheshin me A. dhe se më ka thënë se e ka goditur A. një herë me gërshërë.

I akuzuari L.M. në mbrojtjen e tij deklaroi: se me H. kemi pasur raporte të mira dhe kemi planifikuar që fillimisht të fejojeshim e më pastaj të martoheshim, por përmes telefonit të H. të cilin e kam mbajtur unë më ka shqetësuar A.Sh., duke e thirrur H. dhe me një rast unë jam paraqitur ashtu që kur e ka dëgjuar zërin tim se është deklaruar se po e thërret një shok dhe i njëjti ka filluar të më shaj. Ditën kritike i njëjti ka filluar të më shkruaj dhe unë ia kam kthyer në emër të H. dhe i kam thënë të vijë te radio “ ... ” pasi që aty afër e kam shtëpinë, e me qëllim që të skjarohemi se pse i njëjti po i shkruan H.. Të njëjtin asnjëherë më parë nuk e kam takuar e as që e kam njohur, por që e kam identifikuar përmes fotos në viber. Pasi që i dëmtuari ka ardhur në vendin ku e kisha ftuar kam pyetur se a je ti A. dhe i njëjti më ka thënë se po, e më pastaj të njëjtit i kam thënë se pse po e shqetëson H. dhe ashtu kemi filluar të rrihemi me grushte por kush ka filluar i pari nuk e di. Me atë rast e kam pa një dru në tokë të një gjatësie rreth 70 cm e kam marr dhe kam filluar ta godas A., por i njëjti ma ka kapur drurin dhe drurin e kam gjuajtur në tokë. Më pas më është dukur se i njëjti e ka futur dorën në xhep dhe kam menduar që po e nxjerr ndonjë armë dhe pasi që unë i kisha gërshërët në xhep dhe vetëm kur e kam pa veten se kisha qenë duke e goditur A. por nuk e di sa herë por ndoshta 1-2 herë. Kur kam vërejtur se çka jam duke bërë jam tërhequr pasi që kam pa se ishte duke i rrjedhur gjak edhe pse kam pasur mundësi ta vazhdoja sulmin dhe kam filluar të iku nga vendi i ngjarjes në drejtim të rrugës “ ... ” e më pastaj kahe lagjja “ .. ” deri sa A. ka shkuar në drejtim të shkollës “ ... ”. Gërshërët kanë qenë vetëm një teh pasi që me të njëjtin isha duke e prerë një rrjet dhe e përdorja në formë të skallperit dhe të njëjtën e kam fshehur në oborr. Pasi që isha i frikuar nga Policia unë jam larguar nga shtëpia dhe për rastin jam penduar thellë dhe njëkohësisht i kërkoi falje të dëmtuarit.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.M., avokat S.Rr., në fjalën përfundimtare deklaroi: se nuk është vërtetuar thënia nga aktakuza se i mbrojturi im ta ketë kryer veprën penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës. I akuzuari L.M. që nga fillimi i procedurës e edhe në shqyrtimin fillestar dhe sot në shqyrtim gjyqësor nuk i ka mohuar veprimet e tija, por që me provat e shtjelluara me deklarin e tij dhe të dëshmitarëve në mënyrë bindëse është sqaruar se i njëjti nuk ka pasur për qëllim që të dëmtuarin ta privoi nga jeta. I akuzuari e ka ndërmarr këtë veprim duke e goditur me gërshërë të dëmtuarin në një gjendje të tronditjes psikologjike, por e ka ndërprerë veprimin e mëtejshëm edhe pse ka pasur mundësi që ta vazhdoi me goditje dhe ta privoi nga jeta. Duke pasur parasysh që i njëjti ka pasur mundësi të vazhdoi sulmin, por i njëjti ka hequr dorë vullnetarisht nga sulmi i mëtejshëm e për këtë e dëshmon edhe dëshmitari K.B., dhe duke e pasur parasysh faktin se asnjë person nuk e ka ndarë, konsideroi se i njëjti në rastin konkret duhet të shpallet fajtor dhe të dënohet për veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2. të KPRK-ës duke i pasur parasysh në këtë rast rrethanat lehtësuese si sjelljen e tij të mirë, pranimin e veprimeve të ndërmarra, pendimin e thellë si dhe kërkim faljen.

I akuzuari L.M., në fjalën përfundimtare deklaroi: se e përkrahu në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim, duke premtuar se në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale.

Gjykata bëri shtjellimin dhe analizimin e provave materiale edhe atë: raporti mjekësor me nr. ... e datës 30.04.2017, të lëshuar në emër të dëmtuarit A.Sh., mendimi dhe konstatimit mjeko ligjor i datës 20.07.2017, lidhur me natyrën e lëndimeve, të shkaktuara të dëmtuarit A.Sh., dëshmia mbi konfiskimin e gërshërëve si dhe dokumentacionin lidhur me te.

Pas shtjellimit dhe analizimit të gjitha provave veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK gjykata konstatoi këtë gjendje faktike se me datë 30.04.2017, rreth orës 15,00 h, në ... në rr.” ... ” afër radiostacionit “ ... ” pasi që fillimisht i akuzuari L.M., e kishte ftuar të dëmtuarin A.Sh. përmes shkrimit të fcb. dhe ishte paraqitur në emër të dëshmitares H.R. që të takoheshin në vendin si më lartë dhe duke u pajisur me gërshërë përkatësisht njëërën pjesë të gërshërëve dhe me një shkop druri dhe pasi që i dëmtuari arrin në vendin e ngjarjes, i akuzuari e pyet a je ti A., i dëmtuari përgjigjet se po, ashtu që fillon fjalosja në mes tyre dhe i akuzuari tenton ta godas me shkop druri por që i dëmtuari ia kap shkopin dhe shkopi bie në tokë e më pas gjatë përleshjes e sipër i akuzuari nga xhepi nxjerr gërshërët dhe me të njëjtat e godet tri herë në pjesën e sipërme të shpinës në anën e majtë e më pas edhe në pjesën kokës mbi veshin e majtë dhe me të vërejtur se kishte gjakderdhje i akuzuari e ndërpret sulmin dhe ikë në drejtim të rrugës “ ... ” ndërsa i dëmtuari shkon në shtëpinë e tij e më pas transferohet për ndihmë mjekësore në Spitalin Regjional në Gjilan, ndërsa i akuzuari pas kryerjes së veprës penale largohet nga shtëpia duke qëndruar në arrati derisa me datë 15.07.2017 arrestohet nga ana e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës Stacioni Policor në Gjilan.

Me rastin e konstatimit të gjendjes faktike ju fal besimi provave materiale edhe atë: mendimit dhe konstatimit të ekspertit mjeko ligjor të datës 20.07.2017 lidhur me natyrën e lëndimeve të cilat i janë shkaktuar të dëmtuarit A.Sh., foto dokumentacionin lidhur me faktin se vepra penale është kryer me njëërën pjesë të gërshërëve, mjet ky i përshtatshëm për shkaktimin e lëndimeve të rënda trupore. Po ashtu ju fal besimi dëshmisë së dëshmitarit K.B., lidhur me faktin se i akuzuari dhe i dëmtuari kur ky kishte dalë nga lokali pasi që kishte dëgjuar zhurmën kishte parë se të njëjtit ishin nisur edhe atë i akuzuari në drejtim të rr.” ... ” ndërsa i dëmtuari në drejtim të shkollës fillore “ ... ”. Po ashtu ju fal besimi edhe dëshmisë së dëshmitares H.R., për faktin se i akuzuari kishte komunikuar në emër të saj me të dëmtuarin. Pjesërisht ju fal besimi edhe deklaratës së të dëmtuarit A.Sh. kur deklaroi se ditën kritike përmes fcb, kishte komunikuar me të akuzuarin por duke menduar se po komunikonte me dëshmitaren H.R. ngase fcb, ishte i saj si dhe për faktin se ishte ftuar kinse nga e dëmtuara për të shkuar dhe për ta marr në vendin e ngjarjes. Po ashtu ju fal besimi edhe deklaratës së të dëmtuarit lidhur me kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale si dhe faktit se i akuzuari kishte tentuar që ta godas fillimisht me dru, por edhe për atë që ishte goditur tri herë në pjesën e shpinës e një herë në pjesën e kokës. Por nuk ju fal besimi pjesës së deklaratës së të dëmtuarit kur deklaroi se ishte goditur me një thikë me ngjyrë të bardhë dhe faktit se të akuzuarin e kishte ndarë një person me flokë të bardha ngase kjo pjesë e deklaratës së tij bie në kundërshtim me provat materiale

përkatësisht foto dokumentacionin sa i përket mjetit të kryerjes së veprës penale dhe dëshmisë së dëshmitarit K.B. kur pohon se i kishte vërejtur të akuzuarin dhe të dëmtuarin duke shkuar në drejtimet si më lartë. Pjesërisht ju fal besimi edhe mbrojtjes së të akuzuarit L.M. kur deklaroi se ditën kritike ishte paraqitur përmes fcb në emër të H.R. duke e ftuar në dëmtuarin për të u takuar në kohën dhe vendin e përshkruar si në dispozitiv si dhe për faktin se pasi që e kishte goditur të dëmtuarin me gërshërë duke e vërejtur gjakun e kishte ndërprerë sulmin dhe ishte larguar nga vendi i ngjarjes. Por nuk ju fal besimi pjesës së mbrojtjes së tij kur shton se të akuzuarin e kishte goditur një ose dy herë me gërshërë ngase kjo pjesë e deklaratës bie në kundërshtim me provat materiale përkatësisht me mendimin dhe konstatimin e ekspertit mjeko ligjor të datë 20.07.2017. Po ashtu nuk ju fal besimi pjesës së mbrojtjes së tij kur shton se gërshërët i kishte në xhep rastësisht ngase ishte duke e prerë një rrjet teli për faktin se rrjeta e telit nuk mund të pritët vetëm me një pjesë të gërshërëve si dhe se drurin e kishte gjetur në vendin e ngjarjes meqë kjo pjesë e deklaratës është vetëm përpjekje e tij për ti ikur përgjegjësisë penale, kinse vepra penale është kryer rastësisht, ngase edhe vet i njëjti e pohon se e kishte ftuar të dëmtuarin që të takoheshin në vendin e ngjarjes.

Nga një gjendje e këfillë e konstatuar faktike trupi gjykues bëri rikualifikimin e veprës penale nga vepra penale vrasja në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-ës, në veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2. lidhur me par.1 nën par.1.4 të KPRK-ës, ngase në rastin konkret nuk është vërtetuar qëllimi i privimit nga jeta e të dëmtuarit A.Sh., nga ana e të akuzuarit L.M. ngase pas goditjes me mjet të përshtatshëm – gërshërë, i njëjti vet e kishte ndërprerë sulmin edhe pse po të ekzistonte qëllimi i privimit ka pasur mundësi që edhe më tej ta godas të dëmtuarin, por që i njëjti ishte larguar vullnetarisht. Ashtu që në rastin konkret në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2, lidhur me par.1. nën par.1.4. të KPRK-ës.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPRK-ës, dhe si rrethane lehtësuese ka gjetur se i akuzuari ka pasur sjellje të mira në Gjykatë, se është penduar thellë për kryerjen e veprës penale, dhe faktin se i ka kërkuar falje të dëmtuarit si dhe premtimin e tij se ma nuk do të kryej vepra tjera penale. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh rrezikshmërinë e veprës penale duke qenë se veprimet e tilla të përdorimit të armëve qoftë armë të zjarrit apo armë të ftohta, janë dukuri mjaftë e shpeshtë në mesin e të rinjve e herë, herë me pasoja fatale, se i njëjti kishte siguruar mjetet për ta sulmuar të dëmtuarin dhe faktin se pas kryerjes së veprës penale deri me datë 15.07.2017 kishte qëndruar në arrati. Andaj, të akuzuarit ju shqiptua dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-se.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është i bazuar në nenin 454, të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 161/2017 Me datë. 10.10.2017**

Sekretarja juridike,
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues,
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.